



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 36

Prishtinë, më 19.9.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Frashër Krasniqi, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

Munguan: Nezir Çoçaj dhe Igor Simiq;

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Shaban Murturi, EUSR/EUO, Benina Kusari, Ambasada e SHBA-së, Constantin Sopics, US Embassy, Edita Ferati, KDI, Valbona Bytyçi, EO, Lorik Hajdari, praktikant- PJ, Shefki Kastrati, NDI, Labinot Leposhtica, BIRN, Burim Tahiri, IAP, Florian Sylja, EO, Blerta Bejtullahu, EUSR/EU, Pranvera Regica-Kirkbride, USAID, Afërdita Smaja- Kalaja, EU Office;

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, Kryetare e Komisionit

Stafi mbështetës: Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtur më 7.6, dhe 12.6, 21.6, 26.6, 3.07 dhe 10.7.2018;
3. Votimi i Raportit me amendamente në Projektregulloren e Kuvendit;

4. Votimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës;
5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr.06/L-022 për Ndërmarrjet Sociale;
6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-176 për Hetim Parlamentar;
7. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin nr.06/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-007 për procedurën jokontestimore;
8. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr.06/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/26 për trashëgiminë në Kosovë;
9. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në projektligjin nr.06/L-054 për Gjykatat;
10. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
11. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr.06/L-043 për lirinë e asocimit në organizata joqeveritare;
12. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime të Avokatit të Popullit në lidhje me organizimin e votimit jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare dhe lokale;
13. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtur më 7.6, dhe 12.6, 21.6, 26.06, 3.7 dhe 10.7.2018;

Kryetarja, konstatoi se u miratua pa vërejtje procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 7.6, dhe 12.6, 21.6, 26.6, 3.07 dhe 10.7.2018.

3. Votimi i Raportit me amendamente në Projektregulloren e Kuvendit;

Kryetarja, paraqiti raportin me amendamente të Projektregullore së Kuvendit dhe tha se z. Hajdar Beqa ka qenë kryesues i grupit të punës për Projektregulloren Kuvendit, të cilit më pas ia dha fjalën.

Hajdar Beqa, tha se për këtë pikë debati është konsumuar edhe në Komision, duke pohuar se edhe grupi i punës ka dhënë kontributin e tij, ndaj ka mbetur në fazën e votimit Projektregullore së Kuvendit. Duke i falënderuar të gjithë për kontributin, z. Beqa kërkoi edhe njëherë nga anëtarët e komisionit që t'i përkrahim amendamentet të cilat janë me përkrahje të grupit të punës dhe ta mbështesim në këtë fazë, duke shtuar në fund, se seanca është ajo që vendos.

Kryetarja, theksoi edhe njëherë qëndrimin e saj për sa i përket votimit të Projektregullore së Kuvendit. Arsyeja pse nuk e ka përkrahur është për faktin se në fazën e grupeve punuese, janë bërë disa amendamente të cilat e rrezikojnë edhe funksionimin e Kuvendit, por po ashtu, nuk janë të

favorshme në rrethanat e Kuvendit tonë dhe në përgjithësi të Republikës Parlamentare. Përmes amendamenteve që janë përkrahur në grupin e punës, është bërë kthim pas, andaj nuk e përkrah si të tillë, duke pohuar se vërejtjet kemi mundësi ti themi edhe në seancën e Kuvendit.

Më pas, Haxhiu tha se ne kemi bërë një kthim pas dhe natyrisht që nuk do ta përkrahë si të tillë por vërejtjet tona kemi mundësi që t'i themi edhe në seancën e Kuvendit.

Pas diskutimeve kryetarja, konstatoi se komisioni me 6 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime e procedoi për Kuvend Raportin me amendamente për Projektregulloren për mosmiratim .

4. Votimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Projektligjin nr. 06/L-058 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës;

Albulena Haxhiu, kryetare, paraqiti raportin me amendamente të Komisionit Funkcional për Projektligjin nr. 06/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës. Haxhiu tha se e kam lexuar raportin, por nuk kam vërejtje nga fushëveprimtaria e komisionit sa i përket amendamenteve dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash 6 për dhe 1 abstenim, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 06/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, është në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm;
2. Projektligji mund ti procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Projektligjin nr.06/L-022 për Ndërmarrjet Sociale;

Kryetarja, paraqiti raportin me amendamente të Komisionit Funkcional për Projektligjin nr. 06/L-022 për Ndërmarrjet Sociale, duke i potencuar vërejtjet për këtë projektligj.

Arben Gashi, tha se pjesa e parë është gjykim ndërsa problemi kryesor i këtij projektligji është kolizioni mes neneve, që bie në fushëveprimtarinë e komisionit dhe për këtë arsye i rekomandohet Komisionit Funkcional që ta rishqyrtojë këtë projektligj.

Hajdar Beqa, tha se pajtohen me vërejtjet që u potencuan, të cilat do të paraqiten në rekomandim, ndaj propozoj që ti kthehet Komisionit Funkcional dhe ata ta shqyrtojnë, në të kundërtën mos të dërgohet në seancë pa përkrahjen e komisionit tonë. Në këtë rast i besojmë stafit të komisionit dhe e përkrahim mendimin e tyre që të kthehet në komision.

Kryetarja, më tej shtoi se thelbi është që ka disa hapësira keqpërdorimi dhe i lihet Ministrisë që të nxjerr akte nënligjore për çështje që janë të rëndësishme së veçantë dhe po ashtu bie ndesh me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, Tatimin e të Ardhurave të Korporatave dhe atë për Kundërvajtje.

Arben Gashi, theksoi se këto bashkërisht cenojnë konceptin kushtetues të lirisë së ekonomisë së tregut të lirë.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se i njëjti i procedohet komisionit FunkSIONAL t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Komisioni nuk përkrah procedimin e raportit me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-022 për Ndërmarrjet Sociale.

ARSYETIM

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, para shqyrtimit të dytë të projektligjit, në mbledhjen plenare, për të vepruar në pajtim me nenin 57, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19.9.2018, shqyrtoi projektligjin dhe i njëjti nuk u përkrah nga Komisioni për Legjislacion.

Komisioni vlerësoi se pjesa kryesore e projektligjit e përcaktuar me nenin 5 dhe 6, janë shumë konfuze dhe lë hapësirë për keqinterpretim. Neni 6 paragrafi 6 dhe neni 6 paragrafi, 2 krijojnë diskrecion të gjerë për ministrinë që të ndryshojë (shtojë apo plotësojë) fusha tjera të veprimit për aktivitetet e ndërmarrjeve sociale, me akt nënligjor. Po ashtu, edhe neni 6 paragrafi 2, e lejon këtë diskrecion për ministrinë, që me akt nënligjor të ndryshojë (shtojë apo plotësojë) kategori tjera të personave me vështirësi për tu integruar në tregun e punës. Materia kryesore e projektligjit do të duhej të përcaktojë qartë me këtë ligj dhe jo që ato të mbeten aq lehtë të ndryshueshme me akt nënligjor.

Neni 7, përkatësisht amendamenti 15, nuk është në pajtim me ligjin nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi që në vend të fjalës “parti politike” duhet të jetë “subjekt politik”.

Neni 9 dhe 11 i Projektligjit, janë në kolizion me njëri-tjetrin. Në nenin 9 përcaktohet statusi ligjor i ndërmarrjes sociale, ku në njërin anë për fitimin e statusit të ndërmarrjes kërkon që të përmbushen kriteret sipas këtij ligji, e në anën tjetër në nenin 11 paragrafi 6, thuhet që “Procedurat dhe dokumentacioni i nevojshëm për marrjen, refuzimin dhe humbjen e statusit të ndërmarrjes sociale, si dhe përbërja e komisionit përkatës të Ministrisë, rregullohen me akt nënligjor, të nxjerr nga Qeveria e Kosovës.” Pothuajse në të gjitha dispozitat e Projektligjit materia kryesore është lënë që të rregullohet me akt nënligjor (shih nenet 9.4, 11.6, 19.3, 27.3 29.6). Po ashtu, me amendamentin 24 të Komisionit FunkSIONAL, është bërë edhe më e paqartë, pasi që është përfshirë edhe “përbërja e komisionit përkatës të Ministrisë”, ku në fakt edhe nuk dihet cili është mandati i këtij komisioni.

Neni 27, nuk është në përputhje me ligjin nr. 05/L-029, për tatimin në të ardhurat e korporatave, pasi që ky ligj në nenin 7, ka përcaktuar se cilat kategori lirohet nga tatimi.

Më tej , neni 29 dhe amendamenti 40 i Komisionit Funkcional, nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, pasi që nuk është bërë kategorizimi: personi fizik, juridik dhe personin përgjegjës të personit juridik.

Andaj, duke u bazuar në konstatimet e theksuara, Komisioni rekomandon që projektligji të mos përkrahet për procedim të mëtejshëm.

6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-176 për Hetim Parlamentar;

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim Projektligjin për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-176 për Hetim Parlamentar. Ajo tha se ne e kemi marrë Projektligjin për Hetim Parlamentar, që është nismë legjislative e grupit parlamentar PSD. Ky projektligj ka qenë edhe për mendim në Qeveri por sa kam parë Qeveria nuk ka dhënë ndonjë mendim për këtë, ndonëse ka kaluar afati njëmuor. Dhe, sipas Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Ligjit për Nisma Legjislative, i njëjti procedohet pa mendim të Qeverisë. Kryetarja ia kaloi fjalën z. Frashër Krasniqi, për ta arsyetuar këtë nismë.

Frashër Krasniqi, tha se do të flasë shkurtë pasi që e kemi paraqitë këtë nismë edhe më herët, kur e kemi iniciuar dhe i ftoi që të miratohet. Është shumë e rëndësishme neni 3 paragrafi 1, dhe neni 10, të cilin ne konsiderojmë që duhet të formulohet asisoj që kryesuesi i komisionit të emërohet nga radhët e grupit parlamentar, që është iniciator i Komisionit Hetues Parlamentar. Dhe, pastaj zëvendëskryesuesi të emërohet nga Kuvendi, me propozim të grupit parlamentar. Janë edhe disa ndryshime tjera të cilat kanë synim që komisionet hetimore parlamentare të jenë sa më funksionale dhe të kenë mundësi të realizojnë qëllimin për të cilin krijohet dhe bëri ftesë që të votohet ky projektligj.

Kryetarja, theksoi se dhe unë, po ashtu, grupin që e përfaqësoj e mbështesim si të tillë sepse në të kaluarën ka pasur shumë dilema, madje edhe ne si komision jemi përballur me atë se kush duhet ta drejtojë një nismë për hetim parlamentar. Nuk ka kuptim që në qoftë se e nis një grup parlamentar, ai mos të ketë të drejtën e kryesimit të tij. Nuk e di se ku e kanë marrë si formulim, por megjithatë besoj që është e rëndësishme. Ndërsa, kjo që raporti i miratuar në Kuvend së bashku me rekomandimin i dërgohet Prokurorit të Shtetit për marrjen e masave të nevojshme, besoj që është e rëndësishme, prandaj edhe e mbështesim si të tillë.

Arben Gashi, tha se z. Krasniqi nuk tregoi se cilat praktika i kanë marrë si praktika krahasuese për këtë çështje. Ideja fillestare kur është bërë ky ligj, ka qenë që ta bëjë kryesimin dikush që është i painkuadruar, as pala që akuzohet, as ata që e akuzojnë, por një palë e tretë. Në përgjithësi këto komisione kanë vështirësi, kryesisht janë procese politike mbi bazën e të cilave ngrihet një kauzë politike, e cila mund të marrë edhe karakteristika të akuzës formale sepse mund të dorëzohet në prokurori. Pra, kur e bën një koncept, duhet të kemi parasysh edhe kostot që mund të prodhohen, por në parim ka problem me nënvlerësim të komisioneve hetimore parlamentare kur krijohen.

Sami Kurteshi, pyeti z. Krasniqi se si e kanë parashikuar që një anëtar i komisionit të jetë i pozitës apo opozitës, apo vetëm e keni lënë të përgjithësuar? Gjithashtu pati vërejtje edhe tek neni 2 paragrafi 4, ndërsa tek neni 4, paragrafi 7, tha që nuk sheh ndonjë arsye sepse edhe ashtu Avokati i Popullit nuk i trajton dokumentet e Kuvendit, përveç nëse ka ankesa të drejtpërdrejta për shkelje kushtetuese ligjore. Tek i njëjti nen, por paragrafi 9, mendimin i tij ishte që Prokurori

i Shtetit nuk ka nevojë ta njoftojë Kuvendin sepse e ka një rrugë tjetër që është e rregulluar me Kushtetutë. Në fund, Kurteshi tha nuk e di se cili është synimi që me e njoftua Kuvendin për ecurinë e hetimeve.

Kryetarja, tha se nëse është një dokument i Kuvendit, që përgatitet dhe i dërgohet prokurorisë, besoj se duhet të njoftohen se në cilën fazë është.

Arben Gashi, tha se prokuroria nuk mund ti dërgojë Kuvendit njoftim për një rast konkret sepse prokuroria e merr detyrën e vet sipas detyrës zyrtare.

Hajdar Beqa, tha se nuk dyshoj që Ligji për Hetim Parlamentar ka nevojë për plotësim ndryshime. Po ashtu pati vërejtje tek neni 4, paragrafi 7,8 dhe 9, dhe në fund tha se nuk kanë asnjë kuptim me qenë në këtë ligj. Beqa, ndër të tjera tha se nuk është nevojshme që të përzihen kompetencat me ato që merren me zbatimin e ligjit.

Bilall Sherifi, tha se ajo që kemi vërejtur në ligjin në fjalë, ka qenë dykuptimësia e asaj se kush ka të drejtë të udhëheq dhe shpeshherë bllokohej, sidomos kur ka pak deputetë opozita. Po ashtu, është problem për opozitën të formojë një komision hetimor, përmes të cilit do ta ngarkonte një deputet, i cili nuk është i një grupi parlamentar. Ky problem është hasur gjatë rrugës dhe do të ishte mirë që të zgjidhet. Në pjesët tjera, nuk mendoj që ka pas mangësi dhe në këtë fazë e mbështes këtë projektligj.

Korab Sejdiu, tha se të gjithë pajtohemi që ka pas nevojë të ndërhyrë në ligjin aktual edhe të bëjmë një ndryshim. Ka pas probleme që janë theksuar edhe prej anëtarëve të komisioneve, veçanërisht sa i përket çështjes që u përmend më herët, për mosardhjen e personave të cilët janë ftuar prej komisioneve, për të dëshmuar për komisionin dhe adresimin e atyre çështjeve. Sa i përket nenit 4, paragrafi 8 dhe 9, duhet të kemi parasysh që nuk është shumë e këndshme, kur me ligj e detyron një institucion të pavarur, ti raportojë legjislativit. Prokurori në fund të hetimeve e ka për obligim ose të marrë vendim për pushimin e hetimeve ose të ngre aktakuzë, por nuk e di sa është Kuvendi i dëmtuari, në rastin kur ata e referojnë një rast tek Prokurori. Krejt këto janë çështje publike, sepse Prokurori përfundimisht aktakuzën e dorëzon në Gjykatë dhe ajo bëhet publike.

Sejdiu shtoi se shqetësim është paragrafi 8 i këtij projektligji, se çfarë ndodhë nëse një komision hetimor formohet për një çështje që nuk ndërlidhet me veprë penale, duke pohuar se përse duhet t'ia dërgosh prokurorit të shtetit që nuk ka të bëjë me veprë penale. Këto janë dy çështjet kyçe që duhet të shqyrtohen, para se t'i fusim në ligj sepse i lë shije të keqe, kur ti e urdhëron prokurorin për të njoftuar ty sepse prokurori e ka hierarkinë e vet dhe vepron në bazë të Kodit të Procedurës Penale. Në fund, Sejdiu tha se do të mundohemi që mos të fusim gjëra absurde dhe t'i evitojmë ato gjatë procedimit të ligjit.

Frashër Krasniqi, tha se fillimisht ideja e propozimit të këtyre ndryshimeve është bërë për të fuqizuar ose ti japim një mundësi pak më të mirë komisioneve hetimore parlamentare sepse ideja është që vet ekzistenca e konceptit të Komisionit Hetimor Parlamentar, është për ta forcuar kontrollin ndaj veprimeve të Qeverisë, por edhe institucioneve tjera të shtetit, të cilat janë bartëse ndaj Kuvendit. Sa i përket çështjes së drejtimit të komisionit, mund të jemi dakord në parim, por mendoj që kryesuesi i komisionit, nuk mendoj që është ndonjë pozitë vendimmarrëse, më shumë mendoj që është pozitë menaxhimi e komisionit.

Sa i përket çështjes që e ngriti z. Kurteshi, rreth asaj se si parashihet që të jetë, i pozitës apo opozitës, nuk është e specifikuar sepse nuk e di a mund ta përcaktojmë në këtë punë, por ideja është që mos të ketë dallime shumë të mëdha që të jetë një komision më i balancuar pozitë, opozitë.

Sa i përket çështjes së raportit me rekomandime, se kujt duhet ti dërgohet, unë mendoj që ideja e pavarësisë së gjyqësorit shumë shpesh po banalizohet sepse ne nuk po flasim se si ti tregojmë prokurorit se çka të bëjmë apo çfarë vendimi të marrë, as nuk po kërkojmë që prokurori patjetër me nis hetime për këtë punë. Ajo që ne po kërkojmë, është që Prokurori të raportojë me një raport njoftues Kuvendin. Nuk mendoj që kjo është ndërhyrje në drejtësi sepse nuk jemi duke folur për ndikim të vendimeve të prokurorit, por jemi duke folur, që për njoftimin e tij, të njoftohet Kuvendi. Mendoj që kjo do të ndikonte vetëm në përshpejtimin e disa rasteve sepse gjykatat mund të ndjehen më të detyruara për të proceduar lëndët.

Arben Gashi, tha se tek çështja e kryesimit mund të pajtohem me z. Krasniqi sepse nuk bën ndonjë dallim të madh. Ndërsa, tek pjesa e dytë, se si Kuvendi e dërgon raportin tek Prokurori dhe si Prokurori i përgjigjet Kuvendit, këtu janë disa probleme sepse mandati i deputetit është 4 vjet dhe puna e komisionit lidhet me mandat deri në 6 muaj, përveç në rastet kur Kuvendi i jep një afat shtesë, duke pohuar se sipas procedurës kjo nuk mund të bëhet. Mendoj se problemet kryesore që i kanë komisionet parlamentare, janë që institucionet shtetërore nuk iu përgjigjen. Me këtë ligj, këtë nuk mund t'i forcojmë këto ide sepse duhet të ndërhyjmë në ligjin bazik, duke pohuar se propozuesi ka propozuar tre çështje kryesimin dhe përbërjen, mënyrën e raportimit dhe sallën se si do të ulen.

Kryetarja, tha se e gjithë kjo që u cek më lartë, mund të ndryshohet përmes plotësimit dhe ndryshimit të ligjit aktual.

Korab Sejdiu, tha ekziston një anomali në Rregulloren e Kuvendit, ku një fjali e caktuar i ka dhënë bazë Zyrës Ligjore të Kuvendit, të interpretojnë që nëse vjen një projektligj i cili e ndryshon një ligj tjetër, jo projektligj i ri, por projektligj, i cili e ndryshon një ligj bazik, në bazë të atij interpretimi absurd, nuk mundet të bëhet intervenimi në ligjin bazë. Pra, nëse vjen një projektligj me 4 nene, ato 4 nene mund ti heqësh mund ti përmirësosh por nuk mund të ndërhysh në diçka tjetër apo të shtosh një çështje të re. Kjo është absurde sepse ne jemi legjislaturë dhe duhet të na jepet mundësia që çdo ligj që vjen në Kuvend, mund ta përmirësojmë kornizën ligjore që ekziston në Kosovë, pavarësisht nëse është shkruar keq teknikisht. Në fund tha se më mirë do ishte të tërhiqet projektligji që të kemi mundësi për t'i adresuar këto çështje, në mënyrë që të vjen një projektligj më i përsosur.

Hajdar Beqa, tha se sa i përket kryesimit, kjo pikë tregon se kush e kryeson, ai që e inicion apo jo. Më pas, shtoi që legjislatura që e ka bërë ligjin aktual, pati të drejtë dhe këtë që e ka propozuar PSD-ja, mbi 90 % është e papranueshme sepse janë të rregulluara me ligje tjera.

Frashër Krasniqi, tha se sa i përket çështjeve teknike që i përmendi z. Gashi, besoj që janë të qarta sepse këtu nuk thuhet që Prokurori duhet të sjellë raport në Komision, por sjellë raport në Kuvend. Procedurat se si i raportojnë institucionet njëra-tjetrës, janë të rregulluara. Unë mendoj që ka efekt pozitivë por nëse ju nuk e shihni si të tillë atëherë prapë nuk mendoj që ka dëm prej kësaj pune. Propozoj që të hidhet në votim projektligji. Nëse refuzohet nga komisioni, shkon në seancë pa miratim dhe pastaj vendos seanca vendos, nëse jo, atëherë do të iniciojmë një projektligj tjetër.

Hajdar Beqa, potenco i se në një formë të tillë nuk ka mundësi të përkrahet as nga unë, por as nga PDK-ja. Më tej, shtoi se nëse bëhet një ndryshim i asaj që thanë kolegët, atëherë ndoshta edhe mundet.

Kryetarja, tha se në këtë fazë mund të përkrahet me idenë që të ndryshohet në fazën e dytë.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se Komisioni me 6 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet Projektligji nr. 06/L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-176 për Hetim Parlamentar.

7. Shqyrtimi i raportit me amendamente në Projektligjin nr.06/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-007 për procedurën jokontestimore;

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente për projektligjin nr. 06/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash, 8 për dhe 1 abstenim, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Miratohet Raporti me amendamente për projektligjin nr. 06/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/007 për procedurën jokontestimore;
2. Projektligji nr. 06/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 06/L-007 për procedurën jokontestimore dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim, sipas kompetencës në komisionet kryesore.
3. Amendamentet e miratuara janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali

8. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr.06/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/26 për Trashëgiminë në Kosovë;

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për Trashëgiminë në Kosovë dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Miratohet Raporti me amendamente për projektligjin nr. 06/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për Trashëgiminë në Kosovë;
2. Projektligji nr. 06/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për Trashëgiminë në Kosovë dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim, sipas kompetencës në komisionet kryesore.
3. Amendamentet e miratuara janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali

9. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr.06/L-054 për Gjykatat;

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-054 për Gjykatat dhe ftoi z. Korab Sejdiu që të marrë fjalën, në cilësinë e kryesuesit të grupit të punës për këtë projektligj.

Korab Sejdiu- tha se është një prej rasteve të rralla ku kemi pas koordinim të plotë në mes spektrit politikë që përfaqësohet në Kuvend dhe në këtë komision, sepse ligji në fjalë në Kuvend ka ardhur në gjendje jo të mirë nga Ministria e Drejtësisë. Vetëm me punë dhe angazhim shumë profesional nga të gjithë ne kemi arritur të bëjmë një projektligj përfundimtar, i cili ka kuptim dhe është bazë e mirë mbi të cilën mundet të funksionojë sistemi gjyqësor në Kosovë, duke pohuar se numri i madh i amendamenteve tregon qartë se në çfarë gjendje ka ardhur projektligji. Më tej, ai tha që diskutohen të paktën 2-3 amendamente, të cilat mund të jenë propozime alternative ose janë propozime pa mbështetjen e grupit, ndërsa të tjerat, nëse janë me aprovim të grupit të punës, të mos t'iu hyjmë një nga një sepse nuk është e nevojshme ngase janë diskutuar gjatë punës së grupit të punës nga të gjithë.

Hajdar Beqa, tha se ne e kemi harmonizuar projektligjin me kryesuesin e grupit të punës z. Sejdiu, përmes amendamenteve të propozuara. Beqa propozoi që të gjitha amendamentet që e kanë përkrahjen e grupit të punës, të përkrahen nga komisioni dhe të shkojnë në seancë me përkrahje të komisionit, ndërsa ato që nuk janë përkrahur të shkojnë pa përkrahjen e komisionit dhe seanca të vendosë në lidhje me këto amendamente.

Gjatë votimit të amendamenteve për Projektligjin për Gjykatat nr. 06/L-054

Amendamenti 6, propozim i deputetit Hajdar Beqa, pa përkrahjen Komisionit Funkcional
Deputeti Hajdar Beqa e tërhoqi amendamentin nr. 6, i cili ka të bëjë me nenin 8 paragrafi 2.

Amendamenti 12 ,dy propozime

Kalon propozimi A, i Komisionit Funkcional, i cili ka të bëjë me nenin 13, ndërsa propozimi B i grupit parlamentar Lista serbe nuk kalon.

Amendamenti 13, tri propozime

Kalon propozimi A, i Komisionit Funkcional, i cili ka të bëjë me nenin 14 të projektligjit

Amendamenti 35, dy propozime

Kalon propozimi A, i Komisionit FunkSIONAL, i cili ka të bëjë me nenin 26, nënparagrafi 1.7

Amendamenti 39, dy propozime

Kalon propozimi A, i grupit punues, i cili ka të bëjë me nenin 28 nënparagrafi 2.2.

Amendamenti 40, dy propozime

*Propozimi A u votua me 3 vota Për, ku thuhet se neni 28, nënparagrafi 2.4, riformulohet si vijon
“2.4 të mos jetë i dënuar për vepër penale*

*Kalon propozimi B, me 5 vota Për dhe 3 kundër, ku thuhet se 2.4 është dënuar për vepër penale
me përjashtim të veprave penale nga pakujdesia.*

Amendamenti 43, dy propozime

Kalon propozimi A, i Komisionit FunkSIONAL, i cili ka të bëjë me nenin 30 të këtij projektligji.

Pas diskutimeve dhe votimit të amendamenteve, me dy propozime, kryetarja konstatoi se Komisioni me një zëri nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Miratohet Raporti me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-054 për Gjykatat;
2. Projektligji nr. 06/L-054 për Gjykatat dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim, sipas kompetencës në komisionet kryesore.
3. Amendamentet e miratuara janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali

10. Shqyrtimi i Raportit me amendamente në Projektligjin nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe ftoi z. Sami Kurteshi që të marrë fjalën në cilësinë e kryesuesit të grupit të punës për këtë projektligj.

Sami Kurteshi, tha se këtë ky projektligj ka gjithsej 90 amendamente. Projektligj ka pasur edhe probleme gjuhësore dhe unë mendoj se gjuha dhe ligji janë kategori që nuk mund të ndahen në asnjë mënyrë sepse ligji nuk ka mënyrë tjetër të shprehjes përveç gjuhës. Pra, kërkohet që gjuha të jetë e pastër e qartë dhe e saktë. Shumica e amendamente në këtë projektligj janë me përkrahje të komisionit, por kemi edhe amendamente me nga dy propozime.

Gjatë votimit të amendamenteve për Projektligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës u dhanë këto propozime:

Amendamenti 23, propozim i grupit parlamentar Lista serbe, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Nuk kalon, i cili ka të bëjë me nenin 8 të këtij projektligji.

Amendamenti 25, propozim i deputetes Albulena Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Tërhiqet nga propozimi, i cili ka të bëjë me nenin 9, të këtij projektligji.

Amendamenti 32, propozim i deputetes Albulena Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Ky amendament përkrahet nga anëtarët e komisionit njëzëri, i cili ka të bëjë me nenin 10, të këtij projektligji.

Amendamenti 39, dy propozime

Kalon propozimi B, i amendamenteve të propozuara i cili ka të bëjë me nenin 13 të këtij projektligji.

Amendamenti 46

Amendamenti 46 hiqet, i cili ka të bëjë me nenin 15 dhe mbetet si është i propozuar në projektligj.

Amendamenti 50, propozim i Grupit parlamentar Lista serbe, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Ky amendament nuk kalon, duke marrë 6 vota kundër, i cili ka të bëjë me nenin 16 të projektligjit.

Amendamenti 60, Dy propozime

A. Propozim i deputetit Hajdar Beqa, me përkrahjen e Komisionit Funksional

Kalon propozimi A, i deputetit Hajdar Beqa. Ndërsa, propozimi B, i deputetes Fitore Pacolli shkon pa përkrahjen e komisionit, i cili ka të bëjë me nenin 21 të projektligjit.

Amendamenti 65

Ky amendament u përkrah me 5 vota për dhe 1 kundër, ku pas paragrafit 1.8 të nenit 28, shtohet një paragraf i ri 1.9, ku thuhet Numrin e lëndëve të rigjykim apo rivendosje, apo lëndëve të prishura nga gjykata e lartë.

Amendamenti 68, dy propozime

Kalon propozimi A, i Komisionit Funkcional, i cili ka të bëjë me neni 29 paragrafi 1 të projektligjit

Amendamenti 69, dy propozime

Kalon propozimi A, me 5 vota Për dhe 1 Kundër, i cili ka të bëjë me nenin 28, paragrafi 4, të këtij projektligji.

Amendamenti 74, propozim i Grupit parlamentar Lista serbe, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Ky amendament nuk kalon, i cili ka të bëjë me nenin 31 paragrafi 7, të këtij projektligji.

Pas diskutimeve dhe votimit të amendamenteve, me dy propozime, kryetarja konstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Miratohet Raporti me amendamente për projektligjin nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.
2. Projektligji nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe amendamentet e propozuara, procedohen për shqyrtim, sipas kompetencës në komisionet kryesore.
3. Amendamentet e miratuara janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali.

11. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Projektligjin nr.06/ L-043 për Lirinë e asociimit në organizata joqeveritare;

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funkcional për Projektligjin nr. 06/L-043 për Lirinë e asociimit në organizatave joqeveritare dhe kërkoi anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni njëzëri vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R E K O M A N D I M

1. Projektligji nr. 06/L-043 për Lirinë e asociimit në organizata joqeveritare, është në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm;

2. Projektligji mund ti procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

12. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandimi të Avokatit të Popullit, në lidhje me organizimin e votimit jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare dhe lokale;

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim Raportin me Rekomandime të Avokatit të Popullit, në lidhje me organizimin e votimit jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare dhe lokale, por gjithashtu propozoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës, pasi është një pikë shumë e rëndësishme dhe duhet një diskutim më i thellë.

Kryetarja, konstatoi se anëtarët e Komisionit u pajtuan që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës.

13. Të ndryshme.

Në këtë pikë nuk pati asnjë çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 14:47.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu

Aneks amendamentet për Projektligjin nr.06/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-007 për procedurën jo-kontestimore;

Amendamenti 1

Neni 1 i projektligjit riformulohet si vijon:

Në Ligjin 03/L-007 për procedurën jokontestimore (në tekstin e më tejme ligji), neni 1, paragrafi 1.1 i ligjit bazik, pas fjalës “gjykatat”, shtohen fjalët “dhe në rastet e trashëgimisë noteri”.

Amendamenti 2

Neni 3 i projektligjit ndryshohet si vijon: Në nenin 125 të ligjit, pas fjalës “gjykata” shtohen fjalët “apo noteri”.

Amendamenti 3

Në nenin 4 të projektligjit, në rreshtin e katërt, pas fjalës “interesuar”, vihet “,” dhe shtohet fjala “gjykata” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 4

Neni 5 i projektligjit riformulohet si vijon:

Në tërë tekstin e nenit 128 të ligjit, fjala “gjykatë”, zëvendësohet me fjalët “gjykata apo noteri”.

Amendamenti 5

Neni 6, paragrafi 1 i projektligjit ndryshohet si vijon:

1. Neni 129, paragrafi 1 i ligjit, pas fjalës “gjykata” shtohen me fjalët “apo noteri ” dhe shkronja “e” zëvendësohet me shkronjen “i”.

Neni 6, paragrafi 2, në rreshtin e parë, numri “29”, bëhet “ 129” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 6

Neni 7 i projektligjit riformulohet si vijon: Në nenin 130 të ligjit, pas fjalës “gjykatës”, shtohen fjalët “apo noteri”.

Amendamenti 7

Neni 8 i projektligjit riformulohet si vijon:

Neni 8

Neni 131 i ligjit riformulohet si vijon:

131.1 Marrja e provave dhe të deklaratave për heqjen dorë nga trashëgimia e bën noteri me procesverbal dhe me audio dhe video-incizim.

131.2 Noteri e njofton palën për audio-video-incizim të procesit të marrjes së provave dhe deklaratave.

131.3 Me kërkesën e palës, procedura për marrjen e provave dhe dhënien e deklaratave mund të bëhet pa audio-video-incizim, por kërkesa e palës duhet të evidentohet në procesverbal e shoqëruar me arsyen për këtë kërkesë.

131.4 Materialet e audio-video-incizimit ruhen në arkivin e noterit të bashkangjitura dosjes origjinale dhe mund të jenë të qasshme me kërkesën e palës, deklarata e së cilës është video-incizuar apo institucioneve kompetente.

131.5. Noterët obligohen në sigurimin e pajisjeve funksionale për audio-video-incizim.

Amendamenti 8

Neni 9 i projektligjit, në rreshtin e dytë, pas fjalës “ trashëgimore”, shtohet fjalët “gjkata apo” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 9

Neni 10, paragrafi 2 riformulohet si vijon: 2. Neni 133, paragrafi 2 i ligjit, pas fjalës “në gjykatë”, shtohen fjalët “apo te noterit”.

Amendamenti 10

Neni 10, paragrafi 3 riformulohet si vijon: 3. Neni 133, paragrafit 3 të ligjit, pas fjalës “gjkatës trashëgimore”, shtohen fjalët “apo noterit”.

Amendamenti 11

Neni 11, i projektligjit ndryshohet si në vijim:

Neni 134 i ligjit ndryshohet si në vijim:

“Neni 134

134.1. Të dhënat për hartimin e dëshmisë së vdekjes mund të verifikohen edhe nga të afërmit e personit të vdekur, nga personat me të cilin personi i vdekur ka bashkëjetuar, si dhe nga personat e tjerë që mund të japin të dhëna që shënohen në dëshminë e vdekjes”.

134.2. Në qoftë se gjykatës apo noterit i është dërguar dëshmia e vdekjes jo e plotë ose vetëm certifikata nga regjistri i gjendjes civile, noteri sipas rrethanave të rastit do të kërkojë nga organi kompetent për mbajtjen e regjistrave të gjendjes civile plotësimin e dëshmisë së vdekjes ose verifikimin e të dhënave.”

Amendamenti 12

Pas nenit 11, të projektligjit shtohet neni i ri 12, si në vijim:

Neni 12,

Neni 135 i ligjit fshihet.

Amendamenti 13

Neni 13, paragrafi 1, në rreshtin e tretë, pas fjalës “vendimit të”, shtohen fjalët “gjkatës apo” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 14

Neni 13, paragrafi 2, në rreshtin e parë, para fjalës “Noteri”, shtohet fjala “Gjykata apo”, teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 15

Neni 15 riformulohet si vijon:Neni 142 i ligjit, pas fjalës “gjykatës trashëgimore”, shtohen fjalët “apo noterit”.

Amendamenti 16

Në nenin 16, në rreshtin e dytë, pas fjalës “pasurisë”, shtohen fjalët “gjykata apo” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 17

Neni 17 i projektligjit, ndryshohet si ne vijim:

Neni 145 i ligjit , ndryshohet si në vijim:

“Neni 145

Në qoftë se konstatohet se asnjëri nga trashëgimtarët e pranishëm nuk është i aftë të administrojë pasurinë trashëgimore, e nuk ka përfaqësues ligjor, ose në rast se trashëgimtarët janë të panjohur apo mungojnë, si dhe kur rrethanat tjera kërkojnë kujdes të posaçëm, shërbimi komunal kompetent, në raste të ngutshme, do t’ia dorëzojë pasurinë, ose vetëm një pjesë të saj, për ruajtje personit të sigurt dhe për këtë do ta njoftojë menjëherë gjykatën apo noterin në territorin e të cilës gjendet kjo pasuri.”

Amendamenti 18

Pas nenit 17, të projektligjit shtohet neni i ri 19, si në vijim:

“Neni 19

Neni 146 dhe 147 i ligjit, në tërë tekstin e neneve, pas fjalëve “**gjykata**” dhe “**gjykata trashëgimore**”, shtohen fjalët“**apo noterit**”.

Amendamenti 19

Neni 18 ndryshohet si vijon: Neni 148, paragrafi 2 i ligjit, pas fjalëve “gjykatës trashëgimore”, shtohen fjalët “apo noterit”.

Amendamenti 20

Neni 19, paragrafi 1 riformulohet si vijon: 1. Neni 149, paragrafi 149.1 i ligjit, pas fjalës “gjykata”, shtohen fjalët “apo noterit”.

Amendamenti 21

Neni 20 riformulohet si vijon:

Neni 20

1. Neni 150, paragrafi 150.1, pika b) i ligjit riformulohet si vijon: “kush ia ka dorëzuar gjykatës apo noterit, testamentin për ruajtje”.

2. Neni 150, paragrafi 150.3 i ligjit, pas fjalës “gjykata”, shtohen fjalët “apo noterit”.

3. Neni 150, paragrafi 150.4 i ligjit formulohet me tekstin si vijon:

“150.4 Procesverbalin e nënshkruan gjykatësi apo noterit dhe dëshmitarët.”

Amendamenti 22

Neni 21 riformulohet si vijon:

Në tërë tekstin e nenit 151 të ligjit, pas fjalës “gjykata”, shtohen fjalët “apo noterit”.

Amendamenti 23

Neni 22 riformulohet si vijon:

Në tërë tekstin e nenit 152 të ligjit, pas fjalëve “gjykata trashëgimore”, shtohen fjalët “apo noterit”.

Amendamenti 24

Neni 23, paragrafi 1 riformulohet si vijon: Në nenin 153, paragrafi 1 i ligjit, pas fjalës “gjykatës trashëgimore”, shtohen fjalët “apo noterit” dhe pas fjalëve “e gjykata”, shtohen fjalët “apo noterit”.

Amendamenti 25

Neni 24, paragrafi 1, në rreshtin e pestë, pas fjalës “vdekjes tek”, shtohen fjalët “gjykata apo” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 26

1. Neni 24, paragrafi 2 riformulohet si vijon: 2. Neni 154, paragrafi 1 i ligjit riformulohet si vijon: “Pas inicimit të procedurës trashëgimore apo pas arritjes së dëshmisë së vdekjes, gjykata apo noterit konstaton se a është kompetent për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore. Nëse konstatohet se nuk është kompetent do t’ia dërgojë dosjen e lëndës gjykatës kompetente ose Odës së Noterëve, që ta dërgojë te noterit kompetent sipas radhës alfabetike”.

Amendamenti 27

Neni 24, paragrafi 3 riformulohet si vijon: 3. Në nenin 154, paragrafi 2 i ligjit, fjalët “gjykata të cilës”, zëvendësohet me fjalën “ gjykata apo noterit të cilit”.

Amendamenti 28

Neni 25 riformulohet si vijon:

Neni 25

Neni 155 i ligjit, pas fjalës “gjkata”, shtohen fjalët “apo noteri”.

Amendamenti 29

Neni 26 riformulohet si vijon:

Neni 26

Neni 156, paragrafi 1 i ligjit, pas fjalëve “gjkata trashëgimore”, shtohen fjalët “apo noteri”.

Amendamenti 30

Neni 27

Në tërë tekstin e nenit 157 të ligjit, pas fjalës “gjkata”, shtohen fjalët “apo noteri”.

Amendamenti 31 ka të bëjë vetëm me versionin në gjuhën shqipe.

Në nenin 28, në fund të paragrafit, fjala “trashëgimlënësi”, zëvendësohet me “trashëgimlënësit”.

Amendamenti 32

Neni 29 riformulohet si vijon:

Në tërë tekstin e neneve 158 – 186, pas fjalës “ **gjykatë/a**”, shtohen fjalët “**apo noteri**” si dhe pas fjalës “seancë” fjala “gjyqësore” fshihet.

Amendamenti 33

Neni 30 i paragrafi 1 riformulohet si vijon: “161.1 Përveç njoftimit të drejtpërdrejtë të trashëgimtarëve që janë të njohur, gjykata apo noteri duhet publikuar njoftimin në internet në Portalin Shtetëror të Republikës së Kosovës dhe në Gazetën Zyrtare. Oda e Noterëve do të publikojë në faqen e vet zyrtare njoftimin për iniciimin e procedurës trashëgimore, për të cilat noteri është përgjegjës.

Amendamenti 34

Neni 30, paragrafi 6 hiqet dhe renditja e paragrafëve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 35

Neni 30, paragrafi 9 riformulohet si vijon: 161.9 Trashëgimtarët e identifikuar kanë për detyrë të informojnë gjykatën apo noterin për ndonjë trashëgimtar të mundshëm të paidentifikuar, për të cilët ata janë në dijeni. Trashëgimtarët e identifikuar duhet gjithashtu t’i ofrojnë gjykatës apo noterit të gjitha informatat që ata kanë në lidhje me vendndodhjen e trashëgimtarëve të mundshëm, të cilët nuk mund të gjenden. Deklarimi i rremë para gjykatës apo noterit do të dënohet sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.”

Amendamenti 36 ka të bëjë vetëm me versionin në gjuhën shqipe.

Neni 31, paragrafi 2, në rreshtin e parë, pas fjalës “Njoftimi”, hiqet shkronja “ i ” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 37

Neni 31, paragrafi 3, në rreshtin e katërt, fjalët “të ketë”, zëvendësohen me fjalët “se kanë” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 38

Neni 32, paragrafi 1 riformulohet si vijon: “165a.1 Deklarimi për heqjen dorë nga trashëgimia e paraqitur para gjykatës apo noterit duhet të pasohet nga një bisedë me trashëgimtarin për të siguruar që ai i kupton plotësisht të drejtat e tij për të trashëguar, për t’u siguruar se trashëgimtari nuk është vënë nën presion kundër dëshirës së tij për të hequr dorë, për të vlerësuar arsyet e heqjes dorë, si dhe për ta njoftuar se heqja dorë është e përvokueshme. Gjykata apo noteri bisedën me trashëgimtarin gjatë heqjes dorë e bën pa praninë e trashëgimtarëve të tjerë të mundshëm.”

Amendamenti 39

Neni 32, paragrafi 2 riformulohet si vijon: “165a.2 Nëse gjykata apo noteri është vënë në dijeni se një trashëgimtar është nën shtrëngim për të hequr dorë nga trashëgimia e tij, gjykata apo noteri nuk mund të pranojë heqjen dorë, por do të referojë çështjen te prokurori i shtetit.”

Amendamenti 40

Neni 34, në rreshtin e pestë, pas fjalëve “i cili e “ shtohet fjala “ka” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 41

Neni 35 riformulohet si vijon: Në tërë tekstin e neneve 223-279 të ligjit, varësisht nga konteksti i fjalisë, pas fjalës “gjykatë/a”, shtohen fjalët “apo noteri”.

Amendamenti 42

Neni 36 riformulohet si vijon:

Neni 36

1. Neni 238 i Ligjit, ndryshohet si në vijim:

“Nëse testamenti është përpiluar te noteri në territorin e të cilit testamentlënësi nuk e ka vendbanimin, noteri ka për detyrë ta njoftojë Odën e Noterëve, për përfshirje në regjistër të testamentëve dhe për procedim të mëtejshëm”.

Amendamenti 43

Neni 37 riformulohet si vijon:

Neni 37

Në tërë tekstin e nenit 274 të ligjit, pas fjalëve “gjykata / gjykata e”, shtohen fjalët “apo noteri”..

Aneks amendamentet për Projektligjin nr.06/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/26 për trashëgiminë në Kosovë

Amendamenti 1

Neni 1 i Projektligjit, në rreshtin e katërt fjala “ noteri” zëvendësohet me fjalët “apo noteri “.

Amendamenti 2

Neni 2 i Projektligjit riformulohet si vijon:

“Neni 2

1. Në tërë tekstin e ligjit, përjashtimisht neneve 1, paragrafi 1.3, neni 3 dhe 112, varësisht nga konteksti i fjalisë, pas fjalëve:
 - 1.1. **“Gjykata”** shtohen fjalët **“ apo noteri”**
 - 1.2. **“gjyqtari”** shtohen fjalët **“ apo noteri”**
 - 1.3. **“Gjyqësor”** shtohen fjalët **“ apo noterial”**
 - 1.4. **“gjykatës”** shtohen fjalët **“ apo noterit”**.

Amendamenti 3

Pas nenit 2 të Projektligjit shtohet një nenin i ri me përmbajtjen si vijon:

“Neni 3

Në nenin 12 të ligjit, pas paragrafit 2 shtohet paragrafi i ri si vijon:

“12.3 Nëse bashkëshorti pasjetues nuk ka objekt për banim ai mban të drejtën e tij të përdor objektin banesor- martesor, në të cilin ka jetuar gjatë martesës, deri në vdekjen ose rimartesën e tij. Nëse objekti banesor shitet apo në ndonjë formë tjetër tjetërsohet, bashkëshortit pasjetues i sigurohet objekti i domosdoshëm i banimit.”

Renditja e neneve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 4

Neni 8, paragrafi 1 i Projektligjit riformulohet si vijon: “1. Në nenin 130, paragrafi 1 i ligjit pas fjalës **“gjykatës”** shtohen fjalët **“ apo noterit”**.”

Aneks amendamentet për projektligjin nr.06/L-054 për Gjykatat

Amendamenti 1

Neni 1, në titull hiqen fjalët “dhe fushëveprimi i Ligjit”

Amendamenti 2

Në nenin 2 të Projektligjit, përkufizimet të fillojnë me shkronjë të madhe.

Amendamenti 3

Neni 2 nënparagrafi 1.7 riformulohet si vijon:

1.7 Kryetar i Gjykatës - gjyqtari përgjegjës për menaxhimin e gjykatës dhe sigurimin e funksionimit efikas të saj, ashtu siç është paraparë me këtë ligj;

Amendamenti 4 Propozim i deputetit Korab Sejdiu, me përkrahjen e Komisionit Funksional

Neni 4, paragrafi 1 riformulohet si vijon:

“Gjykatat e themeluara me këtë ligj gjykojnë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës.”

Amendamenti 5

Neni 6 paragrafi 3, riformulohet si vijon:

“3. Gjykatat publikojnë të gjitha aktgjykimet në faqen e tyre zyrtare të internetit, në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit, në pajtim me legjislacionin në fuqi. Këshilli nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij neni.

Amendamenti 6

Në nenin 9 paragrafi 2, në të gjithë nënparagrafet, fjalia të fillojë me shkronjë të madhe.

Amendamenti 7, propozim i deputetes Albulena Haxhiu, me përkrahjen e Komisionit Funksional

Neni 10 paragrafi 8.1, fjalët “dhe Komunën e Hanit të Elezit të hiqet” dhe atë si në vijim:

8.1. dega në Kaçanik, për komunën Kaçanikut

Amendamenti 8, propozim i deputetes Albulena Haxhiu, me përkrahjen e Komisionit Funksional

Neni 10, pas paragrafit 8.1, të shtohet një paragraf i ri dhe atë si në vijim:

8.2 dega në Han të Elezit, për komunën e Hanit të Elezit

Amendamenti 9, propozim i deputetit Hajdar Beqa, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONIT

Neni 11, riformulohet si në vijim: “

Themelimi i degës së Gjykatës Themelore”

1. Nëse në një rën nga komunat e themeluara, në pajtim me Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave, nuk ka degë , dhe vlerësohet se ka nevojë të themelohet dega, komuna me vendim të Kuvendit Komunal, mund të paraqesë kërkesë në Këshill për themelimin e degës.
2. Këshilli shqyrton kërkesat e tilla, dhe pas vlerësimit të ngarkesës me lëndë si dhe rrethanave të tjera, e shqyrton arsyeshmërinë e kërkesës dhe vendos. Këshilli e procedon propozimin varësisht nga natyra e kërkesës së komunës sipas ligjit.
3. Nëse Këshilli e aprovon kërkesën sipas paragrafit 1 (një) të këtij neni për themelim të degës së re, Këshilli i rekomandon Ministrisë së Drejtësisë që të ndërmarrin masat e nevojshme për të propozuar ndryshim plotësimin e këtij ligji.
4. Rrethanat që duhet marrë parasysh gjatë zbatimit të këtij neni përfshijnë, por nuk kufizohen në përmirësimin e qasjes në drejtësi, numrin e popullsisë, pozita gjeografike si dhe faktorët tjerë relevantë.

Amendamenti 10, propozim i deputetit Korab Sejdiu, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONIT

Neni 12 i shtohet paragrafi 4, me tekstin si në vijim:

4. “Çështjet administrative janë kompetencë ekskluzive e Gjykatës Themelore të Prishtinës.”

Amendamenti 11, dy propozime

A. Propozim i Komisionit FunkSIONIT

Neni 13 riformulohet si vijon:

Neni 13 Organizimi i Brendshëm i Gjykatës Themelore

1. Departamentet në vijim veprojnë brenda Gjykatave Themelore, me qëllim të ndarjes së çështjeve sipas natyrës së tyre:

1.1. Në kuadër të Gjykatës themelore në Prishtinë, vepron Departamenti special për lëndët në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, me kompetencë për tërë territorin e Republikës së Kosovës.

1.2. Departamenti për Çështjet Ekonomike që vepron në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe ka juridiksion për gjithë territorin e Republikës së Kosovës ;

1.3. Departamenti për Çështjet Administrative që vepron në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe ka juridiksion për gjithë territorin e Republikës së Kosovës

1.4. Departamenti për Krimet e Rënda, që vepron në selinë e secilës Gjykatë Themelore;

1.5. Departamenti i Përgjithshëm, që vepron në selinë e secilës Gjykatë Themelore, si dhe në secilën degë të Gjykatës Themelore.

1.6. Departamenti për të Mitur, që vepron në kuadër të secilës Gjykatë Themelore.

2. Secila Gjykatë Themelore, e ka kryetarin e Gjykatës, i cili është përgjegjës për menaxhimin dhe punën e Gjykatës Themelore. Secila degë e Gjykatës Themelore ka Gjyqtar Mbikëqyrës që i përgjigjet kryetarit të Gjykatës Themelore përkatëse për punën e degës.
3. Caktimi i lëndëve në departamente përkatëse, brenda gjykatës, bëhet në pajtim me Rregulloren e Këshillit, sipas kompetencës së departamenteve.
4. Themelimi i departamenteve të reja dhe ndryshimi i kompetencës lëndore të departamenteve ekzistuese bëhet me ligj.
5. Në kuadër të Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore të Prishtinës, funksionon Divizioni për Kontestet në lidhje me investitorët e huaj, me juridiksion për tërë territorin e Kosovës.

B. Propozim i grupit parlamentar Lista serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Në nenin 13 të Projektligjit duhet të bëhet harmonizimi i tekstit të tri versioneve gjuhësore.

Amendamenti 12, tri propozime

A. Propozim i Komisionit FunkSIONAL

Neni 14, i Projektligjit riformulohet si vijon;

Neni 14

“ Kompetencat dhe Përgjegjësitë e kryetarit dhe nënkryetarit të Gjykatës

1. Kryetari i Gjykatës Themelore dhe i Gjykatës së Apelit, është përgjegjës për administrimin ditor të gjykatës, në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga Këshilli. Kryetari i Gjykatës organizon dhe bashkërendon funksionimin e gjykatës; mbikëqyr veprimtaritë financiare të gjykatës; dhe ndërmer veprime të cekura me rregullat, procedurat apo urdhëresat e nxjerra nga Këshilli.

2. Kryetari i Gjykatës ka këto përgjegjësi:

2.1 Autorizon dhe inicion procedurat për punësimin, disiplinimin dhe shkarkimin e personelit jogjyqësor, në përputhje me rregulloret e zbatueshme për personelin.

2.2 Kryetari i Gjykatës ka autoritet të përgjithshëm administrativ për menaxhimin e gjykatës si dhe siguron administrim efikas dhe efektiv të drejtësisë nga të gjitha degët, departamentet dhe divizionet e gjykatës.

2.3 Kryetari i Gjykatës, në bashkëpunim me gjyqtarët e gjykatës, zhvillon planin vjetor për menaxhimin e lëndëve dhe cakton lëndët tek departamentet dhe gjyqtarët, në atë mënyrë që të sigurojë zgjidhjen efikase të lëndëve.

2.4 Kryetari i Gjykatës në baza vjetore i dërgon Këshillit një raport mbi suksesin e zbatimit të planit të mëparshëm vjetor për menaxhimin e lëndëve.

2.5 Kryetari i Gjykatës i dërgon Këshillit raport tremujor me shkrim, që adreson punën e gjykatës, identifikon çfarëdo probleme me të cilat ballafaqohet gjykata, si dhe propozon hapa riparues për të adresuar problemet e identifikuar.

2.6 Kryetari i Gjykatës, në bazë të rregullave dhe urdhëresave të Këshillit, do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme, për të siguruar menaxhim efektiv dhe efikas të gjykatës dhe të burimeve të saj, si dhe gjykimin e lëndëve brenda kohës së arsyeshme.

2.7 Kryetari i Gjykatës është përgjegjës për të siguruar se gjykata dhe procedurat para gjykatës janë të hapura dhe transparente për publikun.

2.8 Pas shqyrtimit dhe pranimit nga Këshilli, planet dhe raportet tremujore dhe vjetore mbi menaxhimin e lëndëve do të bëhen publike.

2.9 Kryetari i Gjykatës është përgjegjës për të siguruar qasjen e publikut në gjykata, përfshirë qasjen e personave nga komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë.

2.10 Kryetari i Gjykatës thërret takim vjetor të të gjithë gjyqtarëve për këshillim mbi administrimin e drejtësisë në atë gjykatë; për të analizuar organizimin e gjykatës; për të shqyrtuar dhe propozuar ndryshime në procedura dhe praktika; për të ekzaminuar punën e arritur nga gjykata; si dhe për të adresuar çfarëdo problemi të administratës më të cilin ballafaqohet gjykata. Kryetari i Gjykatës brenda 90 (nëntëdhjetë) ditësh i dërgon Këshillit një raport mbi rezultatet e takimit vjetor të gjyqtarëve.

2.11 Kryetari i Gjykatës kryen edhe punë tjera të përcaktuara me ligj dhe me Rregullore të Këshillit. Kryetari për punën e tij i raporton Këshillit.

2.12 Kryetari i gjykatës mund të delegojë kompetenca të caktuara.

3. Kryetari i Gjykatës, në konsultim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës cakton nënkryetarin e gjykatës nga radhët e gjyqtarëve të gjykatës përkatëse. Mandati i nënkryetarit të gjykatës është i njëjtë me mandatin e kryetarit përkatës.

4. Nënkryetari i gjykatës ushtron detyrat e kryetarit të gjykatës në mungesë të tij apo kur kryetari e ka të pamundshëm ushtrimin e detyrave të tij. Nënkryetari ushtron detyra tjera të cilat i delegohen me shkrim nga Kryetari i Gjykatës.”

B. Propozim i Grupit parlamentar Lista Serbe, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional

Në nenin 14 paragrafi 3, duhet të përdoret versioni i tekstit në gjuhën serbe, kështu që të shkruhet: “Kryetari i Gjykatës së bashku me gjyqtarët në kuadër të gjykatës, do të zhvillojnë planin vjetor për ndarjen e lëndëve brenda departamentit dhe ndërmjet gjyqtarëve....”

C. Propozim i deputetes Fitore Pacolli, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Në nenin 14 Kompetencat (përgjegjësitë) e Kryetarit të Gjykatës të shtohet paragrafi i ri dhe atë si në vijim:

Pika 9. Gjyqtarët nuk përfshihen në çfarëdo komunikimi ex-parte me askënd lidhur me lëndët.

Amendamenti 13

Pas nenit 14 të Projektligjit shtohet nen i ri, me përmbajtjen si vijon:

Neni 15

Gjyqtari mbikëqyrës

1. Gjyqtari mbikëqyrës emërohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në konsultim me kryetarin e Gjykatës përkatëse.
2. Gjyqtari mbikëqyrës drejton dhe mbikëqyrë veprimtarinë, organizimin dhe aktivitetet e administratës gjyqësore të degës.
3. Gjyqtari mbikëqyrës ka autoritet të përgjithshëm administrativ mbi gjithë personelin gjyqësor dhe jogjyqësor brenda degës. Gjyqtari mbikëqyrës brenda degës zbaton rregullat dhe urdhëresat e Këshillit si dhe urdhëresat e kryetarit të Gjykatës Themelore. Gjyqtari mbikëqyrës i raporton kryetarit të gjykatës në baza tremujore mbi nevojat dhe veprimet e degës.
4. Gjyqtari mbikëqyrës me shkrim mund t’ia delegojë përgjegjësitë specifike administrative ndihmës administratorit të degës.
5. Në mungesë të gjyqtarit mbikëqyrës, kryetari i gjykatës cakton një gjyqtar për të ushtruar përkohësisht detyrën e gjyqtarit mbikëqyrës.

Amendamenti 14, propozim i deputetit Korab Sejdiu, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 15, nënparagrafi 1.1, riformulohet si në vijim:

“1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, lidhur me çështjet e tyre të ndërsjella afariste, përfshirë edhe kontestet gjyqësore që burojnë nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.”

Amendamenti 15, propozim i deputetit Korab Sejdiu, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 15, nënparagraf 1.2, riformulohet si në vijim:

“1.2. riorganizim, falimentim dhe shuarjen e shoqërive tregtare, nëse me ligj nuk përcaktohet ndryshe.”

Amendamenti 16, propozim i deputetit Korab Sejdiu, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 15, nënparagrafi 1.4, në fund të paragrafit shtohen fjalët “, përfshirë edhe vlerësimin e kundërligjshmërisë.”

Amendamenti 17, propozim i deputetit Korab Sejdiu, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 15, nënparagrafi 1.5, riformulohet si në vijim:

“1.5 mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të pronësisë industriale, përfshirë markat tregtare, patentat, dizajnin industrial, fshehtësitë tregtare dhe format e tjera të pronësisë industriale të parapara me legjislacionin përkatës.”

Amendamenti 18, propozim i deputetit Korab Sejdiu, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Pas nenit 15 të Projektligjit shtohet nen i ri, me përmbajtjen si vijon:

Neni

Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore të Prishtinës

1. Departamenti për çështje administrative i Gjykatës Themelore të Prishtinës gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj.
2. Të gjitha çështjet në Departamentin për çështje administrative të Gjykatës Themelore gjykohen nga 1 (një) gjyqtar profesionist, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe.
3. Në kuadër të Departamentit për çështje administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës, funksionon Divizioni Fiskal, në lidhje me paditë e ushtruara kundër akteve përfundimtare

administrative, në çështjet që kanë të bëjnë me çështjet doganore dhe tatimore, tatimi mbi pronën e paluajtshme dhe çdo tatim ose kontribut tjetër të aplikuar në Republikën e Kosovës”

Amendamenti 19

Pas nenit 15 të Projektligjit, shtohet një nen i ri, me përmbajtjen si vijon:

Neni

Departamenti Special për lëndët në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës

1. Departamenti Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka kompetencë të shqyrtojë lëndët të cilat bien në kompetencë të PSRK-së, në pajtim me Ligjin për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet pasuese.
2. Të gjitha çështjet në Departamentin Special për lëndët në kompetencë të PSRK-së gjykohen nga trupi gjykues prej 3 (tre) gjyqtarëve profesionistë, nga të cilët njëri duhet të jetë kryesues i trupit gjykues.

Amendamenti 20

Në nenin 17 të Projektligjit, paragrafët 2 dhe 4 hiqen.

Renditja e paragrafëve bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 21

Në nenin 2, pas nënparagrafit 1.2 shtohet një nënparagraf i ri, me përmbajtjen si vijon:

“1.3 Departamenti Special për lëndët në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës

Renditja e nënparagrafëve bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 22, propozim i deputetes Albulena Haxhiu, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 21 paragrafi 2, të hiqet

Amendamenti 23

Neni 22 paragrafi 5, fjalët “Kryetari po ashtu mund të kryej edhe detyra të tjera të parapara me ligj.” hiqen.

Amendamenti 24

Në nenin 22 paragrafi 7, fjalët “Bazuar në rregulloret e përcaktuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Kryetari.” hiqen dhe zëvendësohen me fjalët “ Kryetari i Gjykatës Supreme ka këto përgjegjësi:”

Amendamenti 25

Në nenin 22, pas nënparagrafit 7.3, shtohet një nënparagraf i ri 7.4, me përmbajtjen si vijon:”7.4 Kryetari po ashtu mund të kryej edhe punë të tjera të përcaktuar me ligj.”

Amendamenti 26

Neni 23, i Projektligjit, nënparagrafi 1.1, bartet pas nënparagrafit 1.3 dhe renditja e nënparagrafëve bëhet sipas radhës.

Amendamenti 27

Neni 24,i Projektligjit, në paragrafin 1, fjala “e vendimeve” zëvendësohet me fjalët “e qëndrimeve parimore, mendimeve juridike dhe udhëzuesve” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 28

Neni 24, i Projektligjit, paragrafi 2, fjalët “Këshilli Gjyqësor i Kosovës”, zëvendësohen me fjalët ”Gjykata Supreme” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 29

Neni 25, i Projektligjit, në rreshtin tretë, pas fjalës “gjykatave” shtohen fjalët ”përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj”

Amendamenti 30

Pas nenit 25 të Projektligjit, shtohet një nenin i ri me përmbajtjen si vijon:

“Neni

Administratori i Gjykatës

1. Administratori i gjykatës zgjidhet dhe shkarkohet në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës, në një proces të hapur dhe konkurrues, pas shpalljes publike të pozitës.
2. Administratori i përgjigjet kryetarit të Gjykatës. Përgjegjësitë dhe detyrat e Administratorit të gjykatës përcaktohen me rregullore të Këshillit.
3. Administratori i gjykatës menaxhon dhe mbikëqyrë funksionet administrative të gjykatës në mënyrë autonome, në bashkëpunim me kryetarin e Gjykatës dhe në koordinim me Sekretariatën e Këshillit. Administratori i gjykatës mbikëqyrë:
 - 3.1 hartimin e raporteve të gjykatës, duke përfshirë raportet statistikore dhe të sigurojë që të njëjtat të jenë të sakta dhe të përgatiten me kohë;
 - 3.2 regjistrimin dhe arkivimin e dosjeve të gjykatës dhe lëndëve të mbyllura;

- 3.3 mirëmbajtjen e dosjeve të gjykatës në formë të plotë dhe të saktë;
- 3.4 sigurinë e gjykatës;
- 3.5 stafin administrative të gjykatës;
- 3.6 zbatimin e rregulloreve për personelin gjyqësor;
- 3.7 mirëmbajtjen e saktë të financave;
- 3.8 zbatimin e rregulloreve të Këshillit dhe procedurat e themeluara nga Këshilli;
- 3.9 Administratori cakton, sipas nevojës, stafin administrativ në detyra të caktuara për të siguruar veprimin efektiv dhe efikas të gjykatës;
- 3.10 Administratori siguron qasjen e publikut në regjistrat e gjykatës dhe informacionin që mund të zbulohet për publikun, në pajtim me ligjet në fuqi; dhe
- 3.11 ndërmerr detyra dhe përgjegjësi të tjera, siç mund të caktohen nga kryetari i gjykatës apo gjyqtari mbikëqyrës. “

Amendamenti 31, propozim i deputetit Hajdar Beqa, me përkrahjen e Komisionit Funkcional

Kapitulli IV riformulohet si në vijim:“**KUALIFIKIMET, TË DREJTAT DHE DETYRIMET E GJYQTARËVE**” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 32

Neni 26, i Projektligjit, nënparagrafi 1.2, në rreshtin e fundit fjalët “përfundimisht gjyqtarëve porotë” **hiqen**.

Amendamenti 33

Neni 26, i Projektligjit, nënparagrafi 1.3, në rreshtin e fundit fjalët “me përfundim të gjyqtarëve porotë ” **hiqen**

Amendamenti, 34 dy propozime

A. Propozim i Komisionit Funkcional

Neni 26, i Projektligjit, nënparagrafi 1.7, riformulohet si vijon: “ 1.7 të ketë kaluar provimin për gjyqtar, në pajtim me kushtet dhe procedurat e përcaktuara me rregullore të veçantë të miratuar nga Këshilli.”

B. Propozim i grupit parlamentar, Lista serbe, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional

Në nenin 26, paragrafi 1, pika 1.7, ndryshohet teksti në versionin e gjuhës serbe dhe angleze, dhe njëjtësohet me versionin e gjuhës shqipe.

Amendamenti 35

Neni 26, i Projektligjit paragrafi 2, riformulohet si vijon:

“Për qëllime të këtij neni, përvoja në fushën juridike përfshin përvojën, duke mos u kufizuar, në çështjet juridike në institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare.”

Amendamenti 36

Neni 27 i Projektligjit ndahet në dy nene të veçanta dhe riformulohet si vijon:

Neni

Trajnimi fillestar

1. Pas emërimit nga Presidenti i Kosovës, gjyqtarët, do t'i nënshtrohen trajnimit fillestar, i cili do të organizohet nga Akademia e Drejtësisë. Trajnimi fillestar do të zgjasë 12 (dymbëdhjetë) muaj, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
2. Gjatë trajnimit fillestar, gjyqtarëve mund t'u caktohen raste nën mbikëqyrjen e mentorit.
3. Gjyqtarët e emëruar do të vlerësohen pas rezultateve të trajnimit fillestar, në përputhje me dispozitat relevante të këtij ligji. Periudha e trajnimit fillestar do të vazhdohet për ata gjyqtarë që dështojnë të përfundojnë në mënyrë adekuate trajnimin fillestar, siç është përcaktuar nga Akademia e Drejtësisë.”

Neni

Kushtet e veçanta për gjyqtarë

1. Përveç kualifikimeve minimale, të gjithë kandidatët për emërim për gjyqtarë, me qëllim të emërimit apo avancimit në gjykata, duhet të kenë kualifikimet si në vijim:
 - 1.1. për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në Departamentin për Krime të Rënda apo për të Mitur në Gjykatën Themelore, kandidati duhet të ketë së paku 3 (tre) vite përvojë si gjyqtar në lëmin penal;
 - 1.2. për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në Departamentin e Çështjeve Administrative ose Departamentin e Çështjeve Ekonomike të Gjykatës Themelore, gjyqtari duhet të ketë së paku 6 (gjashtë) vite përvojë në fushën juridike, duke përfshirë edhe përvojën në çështjet administrative dhe ekonomike;
 - 1.3. për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit, gjyqtari duhet të ketë së paku 5 (pesë) vite përvojë si gjyqtar;
 - 1.4. për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën Supreme, gjyqtari duhet të ketë së paku 8 (tetë) vite përvojë si gjyqtar;
 - 1.5 për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në Departamentin Special për lëndët në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, kandidati duhet t'i plotësoj kushtet për të punuar si gjyqtar në Departamentin për Krime të rënda si dhe të ketë vlerësim pozitiv të performancës.

Renditja e neneve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 37

Neni 28 paragrafi 1 i projektligjit, në fund të fjalisë shtohen fjalët “Kushtet dhe procedurat për rekrutimin e gjyqtarëve porotë rregullohen me akt nënligjor, të miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.”

Amendamenti 38

Dy propozime

A. Propozim i Komisionit FunkSIONAL

Neni 28, nënparagrafi 2.2, riformulohet si vijon:”2.2 të këtë moshën më se paku 25 (njëzetepesë) vjeç;”

B. Propozim i deputetes Fitore Pacolli, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Tek neni 28, paragrafi 2.2, të largohet tërësisht.

Amendamenti 39

Neni 28 nënparagrafi 2.4, riformulohet si vijon “2.4 “të mos jenë dënuar për vepër penale me përjashtim të veprave penale të kryera nga pakujdesia”

Amendamenti 40

Neni 28, nënparagrafi 2.5, riformulohet si vijon “2.5 të kenë reputacion të lartë moral në shoqëri dhe integritet personal;”

Amendamenti 41

Neni 29, nënparagrafi 1.4, riformulohet si vijon “1.4 pensionim”

Amendamenti 42, dy propozime

A Propozim i Komisionit FunkSIONAL

Në nenin 30, pas nënparagrafit 1.6, shtohet një paragraf i ri me përmbajtjen si vijon: 1.7.“ Të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Themelore, do të pranojnë një pagë ekuivalente prej 80% të kryetarit të Gjykatës Themelore.

B. Propozim i deputetes Fitore Pacolli, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Në Nenin 30, përmes të cilit përcaktohet paga dhe kompensimi gjyqësor të shtohet paragrafi i ri dhe atë si në vijim:

1.7. Të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Themelore, do të pranojnë një pagë ekuivalente prej 90% të kryetarit të Gjykatës Themelore.

Amendamenti 43

Neni 33 i Projektligjit riformulohet si vijon:

Neni 33

Veprimtaritë profesionale

1. Gjyqtaret me aprovimin paraprak të Këshillit, kanë të drejtë të marrin pjesë në organizata profesionale, takime shkencore, të cilat promovojnë pavarësinë dhe mbrojtjen e interesave profesionale të gjyqtarëve.
2. Gjyqtarët me aprovimin e kryetarëve të gjykatave dhe kryetarët me aprovim të Këshillit, vetëm jashtë orarit të punës, mund të marrin pjesë në veprimtari të cilat janë në përputhje me Kodin e Etikës dhe Sjelljen profesionale të gjyqtarëve.
3. Në pajtim me dispozitat e Kodit të Etikës dhe sjelljes profesionale të gjyqtarëve, gjyqtarët mund të angazhohen në shkrime profesionale dhe shkencore, por nuk mund të botojnë përmbajtjen relevante të dosjeve gjyqësore, gjatë apo pas përfundimit të funksionit gjyqësor, përveç nëse kjo lejohet shprehimisht me ligj apo akt nënligjor, të lëshuar nga Këshilli.
4. Gjyqtaret, për aktivitetet e parapara në këtë nen, pranojnë shpërblim, i cili nuk mund të tejkalojë vlerën prej 25 (njëzetepesë) për qind të pagës bazë, dhe për këtë shpërblim Gjyqtaret e njoftojnë kryetarin e Gjykatës kurse kryetarët e gjykatave e njoftojnë Këshillin.

Amendamenti 44

Neni 34, riformulohet si në vijim:

- “1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës me akt nënligjor përcakton procedurën e përzgjedhjes dhe emërimit, kriteret, të drejtat dhe detyrimet për bashkëpunëtor profesionalë.
2. Çdo gjyqtarë duhet të ketë së paku nga një bashkëpunëtor profesional, që i shërben ekskluzivisht gjyqtarit në fjalë.
3. Këshilli Gjyqësor i Kosovës me akt nënligjor përcakton procedurat e certifikimit dhe emërimit, kushtet, të drejtat dhe detyrimet për përkthyes, interpret dhe ekspertë gjyqësor, si dhe lartësinë e shpërblimit për punën e tyre.”

Amendamenti 45, propozim i deputetit Hajdar Beqa, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Neni 35, paragrafi 5, në rreshtin e tretë, fjala “shpallura” zëvendësohet” me fjalën “miratuara” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 46

Neni 36 i Projektligjit riformulohet si vijon:

“Neni 36
Ndalesat mbi Sjelljen e Gjyqtarëve

1. Gjyqtarët nuk kryejnë asnjë detyrë apo shërbim që mundet të perceptohet si ndërhyrje me pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre, apo që përndryshe nuk është në përputhje me detyrat e një gjyqtari, apo dispozite të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë në Kosovë.

2. Gjyqtarët nuk janë pjesëtarë të një subjekti politik dhe as nuk mund të marrin pjesë në çfarëdo lloj veprimtarie politike. Gjyqtari nuk mund të kandidojë nuk do të kandidojë, mbajë as ushtrijë ndonjë funksion politik.

Amendamenti 47

Neni 37 i Projektligjit hiqet.

Amendamenti 48

Pas nenit 37 të Projektligjit, shtohet nen i ri, me përmbajtjen si vijon:

Neni

Caktimi i gjyqtarëve në Departamentin Special për lëndët në Kompetencë të në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe zgjidhja e lëndëve të pakryera

1. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, më së largu gjashtë muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, do të përzgjedh gjyqtarët të cilët do të shërbejnë në Departamentin Special për lëndët në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, përkatësisht në Departamentin për lëndët në kompetencë të PSRK-së, në kuadër të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Gjykatës së Apelit, në pajtim me dispozitat e ligjit në fuqi.

2. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duhet gjithashtu të ndërmarrë të gjitha masat për të funksionalizuar Departamentin Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe asaj të Apelit, duke përfshirë rekrutimin e stafit mbështetës si dhe bashkëpunëtorëve profesionalë

3. Gjyqtarët që caktohen të punojnë në Departamentin Special në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe në Departamentin për lëndët në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, në Gjykatën e Apelit, mund të angazhohen në trupe gjyqese për gjykimin e lëndëve në kuadër të Departamentit për Krime të Rënda në Gjykatën Themelore në Prishtinë, respektivisht në Gjykatën e Apelit.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, lëndët e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, për të cilat ende nuk është mbajtur shqyrtimi fillestar, do të transferohen për shqyrtim në Departamentin Special për lëndët në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Lëndët për të cilat është mbajtur shqyrtimi fillestar, do të vazhdojnë të shqyrtohen në gjykatat përkatëse, deri në përfundimin e tyre.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, lëndët e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës që janë në Gjykatën e Apelit, do të vazhdojnë të shqyrtohen nga kolegji përkatës, i cili e ka lëndën në

shqyrtim në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Lëndët e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës që pranohen në Gjykatën e Apelit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të shqyrtohen nga Departamenti për Lëndët në Kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Amendamenti 49

Pas nenit 37 të Projektligjit, shtohet një nen i ri, me përmbajtjen si vijon:

Rregulloret e përcaktuara në këtë ligj do të nxirren në afat prej 1 (një) viti, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Amendamenti 50

Në nenin 38 të Projektligjit, pas nënparagrafit 1.4, shtohet një nënparagraf i ri 1.5, me përmbajtjen si vijon: “ Neni 215, paragrafi 2 i kodit nr. 04/L-123 i procedurës penale:

Aneks amendamentet për Projektligjin nr.06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;

Amendamenti 1

Neni 1, në titull hiqen fjalët “dhe fushëveprimi i Ligjit”.

Amendamenti 2, propozim i deputetes Albulena Haxhiu, me përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 2, paragrafi 1.4, përkufizimi Qeveria – Qeveria e Republikës së Kosovës, të hiqet.

Amendamenti 3

Neni 2, paragrafi 1.7, hiqet. Renditja e nënparagrafëve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 4

Në nenin 2 shtohet një paragraf i ri me përmbajtjen si vijon:” 2. Fjalët e një gjinie përfshin edhe gjininë tjetër.”

Amendamenti 5

Neni 3, nënparagrafi 1.2 riformulohet si vijon:” 1.2.siguron pavarësinë, mosdiskriminimin, proporcionalitetin, profesionalizmin dhe paanshmërinë e sistemit gjyqësor;”.

Amendamenti 6

Neni 3,nënparagrafi 1.4 riformulohet si vijon:

“1.4. Siguron që gjykatat të respektojnë parimet e mosdiskriminimit, proporcionalitetit, si dhe të drejtat e njeriut dhe të barazisë gjinore, të garantuara me Kushtetutë dhe me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare që zbatohen në Republikën e Kosovës;”

Amendamenti 7

Neni 3, nënparagrafi 1.5, në rreshtin e katërt, fjala “afirmative”, hiqet dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 8, propozim i deputetes Albulena Haxhiu, me përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 5.1 i projektligjit të riformulohet si vijon:

Anëtarët e Këshillit Gjyqësor nuk mbajnë përgjegjësi penale apo civile për mendimet e shprehura brenda fushëveprimit të tyre si anëtarë të Këshillit.

Amendamenti 9, propozim i deputetes Albulena Haxhiu, me përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 5.2 i projektligjit, të hiqet.

Amendamenti 10

Neni 5, paragrafi 3 riformulohet si vijon: “3. Këshilli njoftohet pa vonesë kur ngritet aktakuzë apo arrestohet anëtari i Këshillit.”

Amendamenti 11

Neni 7, nënparagrafi 1.1 riformulohet si vijon:”1.1 Vendos për organizimin, menaxhimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të gjykatave sipas ligjit;”.

Amendamenti 12

Neni 7, nënparagrafi 1.2 riformulohet si vijon:

1.2. I propozon Presidentit emërimin, riemërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve, si dhe siguron se të gjithë kandidatët e propozuar i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj, sipas procedurave përkatëse ligjore;”.

Amendamenti 13

Neni 7, nënparagrafi 1.3, në rreshtin e tretë, fjalët “si dhe sigurimin” ,zëvendësohet me fjalën “siguron” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 14

Neni 7, nënparagrafi 1.5, në rreshtin e parë, fjala “vendos”, zëvendësohet me fjalët “Siguron zbatimin”, dhe në rreshtin e katërt, hiqen fjalët “aftësisë profesionale” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 15

Neni 7, nënparagrafi 1.6, në rreshtin e dytë, fjalët “pozita gjyqësore”, zëvendësohen me fjalët “pozita në gjyqësor;”.

Amendamenti 16

Neni 7, nënparagrafi 1.8 riformulohet si vijon:”1.8. vendos dhe mbikëqyrë zbatimin e kriterëve për përbërjen etnike të juridiksionit territorial të gjykatës përkatëse dhe për plotësimin e vendeve të lira të punës, të garantuara për anëtarë të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë;”.

Amendamenti 17

Neni 7, nënparagrafi 1.11 riformulohet si vijon: “1.11 bën inspektimin gjyqësor;”.

Amendamenti 18

Neni 7, nënparagrafi 1.12 riformulohet si vijon:” administron gjyqësorin;”.

Amendamenti 19

Neni 7, nënparagrafi 1.13 riformulohet si vijon:”1.13. harton dhe mbikëqyrë buxhetin për gjyqësorin;”.

Amendamenti 20

Neni 7, nënparagrafi 1.15 riformulohet si vijon:” 1.15 vendos kriteret për vlerësimin e rregullt të gjyqtarëve;”.

Amendamenti 21

Në nenin 7, pas nënparagrafit 1.15, shtohen dy nënparagrafë të rinj si vijon:

1.16 vendos për ngarkesën me lëndë të gjykatave;

1.17 siguron funksionimin efikas të gjykatave;

Renditja e nënparagrafëve në vazhdim, bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 22

Neni 7, nënparagrafi 1.23, fjalët “ në ligj”, zëvendësohen me fjalët “me ligj”.

Amendamenti 23, propozim i Grupit Parlamentar Lista Serbe, pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 8, paragrafi 1, pika 1.3 e projektligjit, ndryshohet në këtë mënyrë:

“3 anëtarë i zgjedhin anëtarët e Kuvendit, të cilët kanë vende të rezervuara apo të garantuara për përfaqësuesit e komunitetit serb në Kosovë, ndërsa më së paku njërin nga ta, do të duhej të bëhet gjyqtar”.

Amendamenti 24

Neni 8, paragrafi 5 riformulohet si vijon: “5. Të gjithë anëtarët e Këshillit duhet të jenë të aftë të kontribuojnë në menaxhimin dhe funksionimin e gjykatave në Kosovë. Profesionistë të respektuar, mund të emërohen jashtë fushës ligjore dhe mund të përfshijnë persona me ekspertizë në menaxhim, financa, teknologji informacioni ose shkencat shoqërore.”

Amendamenti 25

Neni 9, nënparagrafi 1.4 riformulohet si vijon:”1.4 personi që ushtron funksion në cilindo subjekt politik, shoqatë apo fondacion të lidhur me ndonjë subjekt politik;”.

Amendamenti 26

Neni 9, nënparagrafi 1.5 riformulohet si vijon:”1.5. personi që punon në administratë, përfshirë personat që kryejnë detyra në Qeverinë apo në organet administrative, në institucionet e themeluara me Kushtetutë apo të krijuara përmes legjislacionit;”.

Amendamenti 27

Në nenin 9, pas nënparagrafit 1.5, shtohen tre nënparagrafë të rinj si vijon:

“1.6 një (1) anëtar i zgjedhur i Këshillit shkarkohet nga Këshilli, nëse ai nuk jep dorëheqje apo pezullon pozitën e cila është në mospërputhje, para emërimit si anëtar i Këshillit;

1.7 Është prokuror.”

1.8 Gjyqtar me mandat fillestar.”

Amendamenti 28

Në nenin 9, paragrafi 2, në fund të fjalisë, shtohen fjalët “apo nuk e pezullon pozitën sipas nënparagrafit 1.6 të këtij neni”.

Amendamenti 29

Në nenin 10, në titull, pas fjalës “Këshillit”, shtohen fjalët “nga Kuvendi”.

Amendamenti 30

Në nenin 10, paragrafi 9 riformulohet si vijon:” 9. Nëse në rrethin e parë, kandidatët e propozuar nga Komisioni përkatës i Kuvendit nuk marrin shumicën e votave të të gjithë deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, atëherë në raundin e dytë konsiderohet i zgjedhur kandidati me numrin më të madh të votave.”

Amendamenti 31, propozim i deputetes Albulena Haxhiu, me përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 10, paragrafi 10.10 të riformulohet si në vijon:

10. Shkarkimi i anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi, bëhet nga Kuvendi me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, me propozim të Komisionit përkatës ose Këshillit.

Amendamenti 32

Neni 11, nënparagrafët 2.6, 2.7 dhe 2.8, hiqen.

Amendamenti 33

Neni 11, paragrafi 3, pas fjalës “ i drejtohet” shtohen fjalët “ dhe i dorëzon raport me shkrim” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 34

Neni 12, paragrafi 1 riformulohet si vijon: ”1 Anëtarët e Këshillit zgjidhen për një mandat 5 vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.”.

Amendamenti 35

Neni 12, paragrafi 2, hiqet.

Amendamenti 36

Neni 12, paragrafi 3 riformulohet si vijon: “3. Kryesuesi, zëvendëskryesuesi, kryetari i Komisionit për Çështje Normative, kryetari për Çështjen e Vlerësimin të Performancës dhe kryetari për administrimin e gjykatave, shërbejnë në Këshill, me kohë të plotë dhe pezullojnë detyrën e gjyqtarit.

Amendamenti 37

Neni 12, paragrafi 6 riformulohet si vijon:” 6. Anëtari i Këshillit që para fitimit të mandatit ka qenë i punësuar në sektorin publik ose në institucionin që financohet me mjete publike, ka të drejtë vazhdimin e funksionit në pozitën e tij të njëjtë ose në pozitë të rangut të njëjtë, pas përfundimit të mandatit të anëtarit në Këshill.”

Amendamenti 38

Neni 13, nënparagrafi 1.8 riformulohet si vijon : “është dënuar për vepër penale me përjashtim të veprave penale të kryera nga pakujdesia”

Amendamenti 39

Neni 13, paragrafi 2 riformulohet si vijon:

“2. Anëtarët e Këshillit shkarkohen nga funksioni para skadimit të mandatit për të cilin janë zgjedhur, nëse është shqiptuar masë disiplinore shkarkim nga Këshilli Gjyqësor;”.

Amendamenti 40

Neni 14, paragrafi 2, në rreshtin e dytë, fjalët “njëzet e katër (24)” zëvendësohen me fjalët “dyzet e tetë (48)” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 41

Neni 14, nënparagrafi 3.1, në rreshtin e parë, hiqet fjala “zyrtar” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 42

Neni 14, pas paragrafit 3, shtohet një paragraf i ri, me përmbajtjen si vijon:

“4. Në çdo rast kur Këshilli merr vendim për mbylljen e takimeve, vendimi lidhur me mbylljen do të jetë publik dhe i arsyetuar, sipas ligjit në fuqi.”

Renditja e paragrafëve në vazhdim, bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 43

Neni 14, paragrafi 5, në rreshtin e njëmbëdhjetë, fjala “e emergjencës”,zëvendësohet me fjalën “urgjente” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 44

Në nenin 14, pas paragrafit 5, shtohet një paragraf i ri si vijon:” Vendimet dhe të gjitha politikat e miratuara nga neni 1 i këtij ligji, do të publikohen në faqen zyrtare të Këshillit, brenda pesë ditëve nga miratimi i tyre.

Amendamenti 45

Në nenin 16, nënparagrafi 1.2, hiqet. Renditja e nënparagrafëve në vazhdim, bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 46, propozim i deputetit Hajdar Beqa, me përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 16

Komisionet e Këshillit

Shtohet nënparagrafi 1.6. si vijon: “*Komisioni për Trajnime*”.

Amendamenti 47

Në nenin 16, paragrafi 3 riformulohet si vijon:”3. Komisionet, nga paragrafi 1 i këtij neni, udhëhiqen nga anëtarët e Këshillit.”.

Amendamenti 48, propozim i Grupit Parlamentar, Lista Serbe, pa përkrahjen e Komisionit funksional

Në nenin 16 të projektligjit shtohet paragrafi 5 si vijon:

“Me rastin e zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit vendet për përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë duhet të jenë të garantuara”.

Amendamenti 49

Neni 17 paragrafi 2 riformulohet si vijon:” 2. Këshilli menaxhon buxhetin vjetor për sistemin gjyqësor në Republikën e Kosovës.”

Amendamenti 50

Neni 18, paragrafi 2 riformulohet si vijon:” 2. Anëtarët jogjyqtarë të Këshillit që nuk janë me orar të plotë, kanë të drejtë në kompensim për punën e tyre si anëtarë të Këshillit. Këshilli do të miratojë skemën e kompensimit.”

Amendamenti 51

Neni 18, paragrafi 3 riformulohet si vijon:” 3. Gjatë mandatit të tyre, kryesuesi si dhe anëtarët gjyqtarë me orar të plotë pranojnë vetëm pagën e përcaktuar me ligj, përveç për rimbursime të shpenzimeve të arsyeshme dhe të nevojshme që ndërlidhet me ushtrimin e detyrave të tyre, siç përcaktohet në paragrafin 5 të këtij neni.

Amendamenti 52

Neni 18, paragrafi 4, në rreshtin e dytë, fjala “shërbimit”, zëvendësohet me fjalën “mandatit” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 53

Neni 20, nënparagrafi 2.5 riformulohet si vijon:”2.5 aftësinë për të kryer detyrat në mënyrë të paanshme, të ndershme, me kujdes dhe me përgjegjësi;”

Amendamenti 54

Neni 20, nënparagrafi 2.7, hiqet. Renditja e nënparagrafëve në vazhdim, bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 55

Neni 20, paragrafi 3, hiqet. Renditja e paragrafëve në vazhdim, bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 56

Neni 20, paragrafi 4, në rreshtin e katërt, fjalët” për pranim në gjyqësor të miratuara nga Këshilli me akt nënligjor.” zëvendësohen me fjalët “e përcaktuara me ligj”.

Amendamenti 57

Në nenin 20, pas paragrafit 4, të shtohet një paragraf i ri, si vijon:

“5. Procedura për vlerësimin e përshtatshmërisë së kandidatit për t’u bërë pjesë e gjyqësorit do të bëhet përmes vërtetimit të të dhënave të dorëzuara nga kandidati, të dhënat nga regjistrat publikë relevantë për vlerësim, përfshirë verifikimin standard të regjistrave për të kaluarën kriminale.

Amendamenti 58, dy propozime

Propozim i deputetit Hajdar Beqa, me përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 21 – Njësia për Verifikim

Neni fshihet në tërësi.

B. Propozim i deputetes Fitore Pacolli, pa përkrahjen e Komisionit funksional

Neni 21, paragrafi 1 duhet të ndryshohet si vijon:

1. Procedura për verifikimin e të kaluarës të kandidatit duhet të bëhet me kujdes maksimal dhe në mënyrë strikte, në pajtim me parimet e sundimit të ligjit. Këshilli mund të kërkojë një kontroll standard për dosje penale dhe baza të tjera nga policia, nëse të dhënat e ofruara nga policia rreth të kaluarës së kandidatit, të cilat bien në kundërshtim me ligjin, mund të rezultojë në diskualifikim të kandidatit.

Amendamenti 59

Neni 25, paragrafi 2, në rreshtin e gjashtë, fjala “paraqesë”, zëvendësohet me fjalën “propozoj”, teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 60

Neni 27, në titull, fjala “detyra”, zëvendësohet me “funksioni”, teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 61

Neni 28, nënparagrafi 1.3 riformulohet si vijon:”1.3 aftësinë profesionale, bazuar në rezultatin e punës gjatë periudhës së vlerësimit, përfshirë pjesëmarrjen në forma të organizuara të trajnimit ku është vlerësuar performanca;”.

Amendamenti 62

Neni 28, nënparagrafi 1.5 riformulohet si vijon:”5 aftësinë për të kryer detyrat në mënyrë të paanshme, të ndershme, me kujdes dhe me përgjegjësi;”.

Amendamenti 63

Neni 28, pas nënparagrafit 1.8 shtohet një nënparagrafë i ri si vijon:

“1.9 Numrin e lëndëve të kthyera në rigjykim apo rivendosje, apo lëndëve të prishura nga gjykata më e lartë;”.

Amendamenti 64

Neni 28, paragrafi 3, në rreshtin e parë, fjala “pranon”, zëvendësohet me fjalën “njoftohet me” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 65

Neni 28, paragrafi 4 riformulohet si vijon: “4 Vlerësimi i rregullt i performancës së gjyqtarëve me mandat të përhershëm bëhet çdo tri (3) vjet. Mënyrën e përzgjedhjes së gjyqtarëve për vlerësim të rregullt të performancës, Këshilli e përcakton me akt të brendshëm.”

Amendamenti 66, dy propozime

A. Propozim i Komisionit funksional

Neni 29, paragrafi 1 riformulohet si vijon:“1. Këshilli mund të transferojë një gjyqtar në një gjykatë tjetër për një periudhë deri në një (1) vit, në rastet kur gjykata tjetër ka numër të pamjaftueshëm të gjyqtarëve për shqyrtimin e lëndëve apo me qëllim të ngritjes së efikasitetit.”

B. Propozim i Grupit Parlamentar Lista Serbe, pa përkrahjen e Komisionit funksional

Është e nevojshme që të përshtatet versioni në gjuhën serbe i nenit 29, paragrafi 1 i projektligjit me gjuhën shqipe dhe angleze.

Amendamenti 67

Neni 29, paragrafi 4, në rreshtin e parë, fjalët “në asnjë rast”, hiqen dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 68

Neni 29, paragrafi 6, në rreshtin e pestë, fjalët “gjashtë (6) mujore”, zëvendësohen me fjalët “një (1) vjeçare” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 69

Neni 29, paragrafi 7, në rreshtin e dytë, fjalët “gjashtë (6) mujore”, zëvendësohen me fjalët “një (1) vjeçare” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 70

Neni 31, paragrafi 5 riformulohet si vijon:” 5.Kryetarët e gjykatave emërohen me një mandat pesë (5)vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje. Pas përfundimit të mandatit si kryetar i gjykatës, gjyqtari do të vazhdojë të shërbejë si gjyqtar në të njëjtën gjykatë, në të cilën ishte emëruar fillimisht.”

Amendamenti 71

Neni 31, paragrafi 6 riformulohet si vijon:” 6. Gjyqtarët mbikëqyrës emërohen me një mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje. Pas përfundimit të mandatit si gjyqtar mbikëqyrës, gjyqtari do të vazhdojë të shërbejë si gjyqtar në të njëjtën gjykatë, në të cilën ishte emëruar fillimisht.”

Amendamenti 72, propozim i Grupit Parlamentar Lista Serbe, pa përkrahjen e Komisionit funksional

Ndryshohet neni 31, paragrafi 7 i projektligjit si vijon:

Në mënyrë që të sigurohet që gjykatat të mbajnë natyrën multietnike të Kosovës, pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në Kosovë do të kenë vendet e garantuara, në kuadër të udhëheqjes së gjykatave, duke përfshirë edhe pozitat e kryetarëve të gjykatave dhe të gjyqtarëve mbikëqyrës.

Amendamenti 73

Neni 31, paragrafi 8, në rreshtin e katërt, fjalët “në aktin nënligjor të nxjerrë nga Këshilli”, zëvendësohen me fjalët “me ligj”.

Amendamenti 74

Pas nenit 32 të projektligjit, shtohet një nen i ri, me përmbajtjen si vijon:

Neni 33

Mbrojtja Gjyqësore

1. Gjyqtari ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës, ndaj vendimeve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, lidhur me shkarkimin apo propozimin për shkarkim të Kryetarit të Gjykatës Supreme, vendimeve lidhur me vlerësimin e performancës së gjykatësve dhe vendimeve disiplinore, që për pasojë kanë uljen në detyrë të gjykatësve.

2. Gjykata Supreme, brenda 90 ditëve nga koha e pranimit të ankesës, duhet të vendosë sipas meritës.”

Renditja e neneve në vazhdim, bëhet sipas numrave me radhë.

Amendamenti 75

Neni 33, paragrafi 2, në rreshtin e katërt, pas fjalës “Themelore dhe”, shtohet parafjala “nga” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 76

Neni 33, paragrafi 4, në rreshtin e katërt, fjala “me diskrecion”, hiqet dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 77

Neni 34, nënparagrafi 1.1, në rreshtin e parë, hiqet lidhëza “dhe” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 78

Neni 34, nënparagrafi 1.2, fjalët “propozon politika dhe”, zëvendësohen me fjalën “harton” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 79

Neni 34, nënparagrafi 1.7, në rreshtin e parë, pas fjalës “administrative”, shtohen fjalët “dhe profesionale”, dhe në rreshtin e tretë, fjala “autoritete”, zëvendësohet me fjalën “autorizime” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 80

Neni 36, nënparagrafi 1.1 riformulohet si vijon:”1.1. ndihmon Komisionin për Administrimin e Gjykatave, si dhe Komisionin për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve, në vlerësimin e punës së gjykatave, dhe”.

Amendamenti 81

Neni 37, nënparagrafi 1.2, në fund të fjalisë, shtohen fjalët “në koordinim me sekretariatit.”

Amendamenti 82

Neni 37, nënparagrafi 1.3 riformulohet si vijon:”1.3 i raporton Këshillit.”

Amendamenti 83

Neni 38, paragrafi 2, fjalët “ndërsa për çështje administrative ndaj drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit.”, zëvendësohen me fjalët “ në koordinim me sekretariatit.”

Amendamenti 84

Neni 41, paragrafi 1, në rreshtin e tretë, fjala “mund të”, hiqet dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 85

Neni 41, paragrafi 3 në rreshtin e tretë, fjalët ” dhe mund të”, hiqen dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 86

Në nenin 41, pas paragrafit 3, shtohet një paragraf i ri me përmbajtjen si vijon: “4. Kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët mbikëqyrës qëndrojnë në këtë detyrë deri në mbarim të mandatit të tyre aktual.”

Amendamenti 87

Në nenin 42, paragrafi 1, fjalët “prej gjashtë (6) muajsh”, zëvendësohen me fjalët “prej një (1)viti” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 88

Në nenin 42, paragrafi 2, në rreshtin e tretë, fjala “ duhet”, zëvendësohet me fjalën “mund” dhe teksti vazhdon si në projektligj.